



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Maj 2021

Nr: 367

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË  
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU FIER, ZJ. GENTIANA XHEMAL CAKRANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe nenit 164, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 1084 prot., datë 04.05.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit, të z. Bashkim Muhamet Fino, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, Qarku Fier, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.



Data: 25 Maj 2021

Nr. 367

Dhënie e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani.

Partia Socialiste e Shqipërisë, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 65, datë 20.03.2017.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.06.2017 dhe miratoi listën shumemërore të deputetëve të zgjedhur për secilin subjekt në çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste e Shqipërisë për zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 10 (dhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, janë numri rendor 01 (një) z. Erion Mirdash Braçe, numri rendor 02 (dy) zj. Adelina Petraç Rista, numri rendor 03 (tre) z. Bashkim Muhamet Fino, numri rendor 04 (katër) z. Ismet Shyqyri Beqiraj, numri rendor 05 (pesë) zj. Antoneta Nasi Dhima, numri rendor 06 (gjashtë) z. Bujar Avdulla Çela, numri rendor 07 (shtatë) zj. Tatiana Nuredin Piro(Nurçe), numri rendor 08 (tetë) z. Anduel Fatmir Xhindi, numri rendor 09 (nëntë) z. Gramoz Kaso Ruçi dhe numri rendor 10 (dhjetë) z. Xhevit Qemal Bushaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore, Qarku Fier, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, miratuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 291, datë 07.05.2017, rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), zj. Gentiana Xhemal Cakrani.

Me shkresën nr. 5035 prot., datë 07.05.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për Deputet, të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për Deputet, zj. Gentiana Xhemal Cakrani, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2160 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi



Data: 25 Maj 2021  
Nr. 367

Dhënen e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidati të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani.

kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Gentiana Xhemal Cakrani, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 5128 prot., datë 11.05.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 5127 prot., datë 11.05.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Gentiana Xhemal Cakrani dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Gentiana Xhemal Cakrani.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4934/1 prot., datë 18.05.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Gentiana Xhemal Cakrani, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Gentiana Xhemal Cakrani, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Bashkim Muhamet Fino, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, i renditur me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), zj. Gentiana Xhemal Cakrani.



Data: 25 Maj 2021  
Nr. 367

Dhënie e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani.


## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe nenit 164, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Dhënie e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Data: 25 Maj 2021

Nr. 367

Dhënie e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani.